



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT NJËSIA E STATISTIKËS

Lënda : Informacion vjetor në lidhje me të dhënat e grumbulluara nga Njësia e Statistikës.

Njësia e Statistikës pranë Këshillit të Qarkut është ngritur me Urdhrin Nr. 154, datë 15.10.2019 .

Njësia e Statistikës kishte për qëllim dhe funksion mbledhjen, grumbullimin, përpunimin dhe përgatitjen për publikim të statistikave zyrtare që lidhen me Qarkun e Beratit, në fusha me interes zhvillimi si ; demografia, zhvillimi rajonal, punësimi, turizmi, kultura, arsimi, shëndetësia etj.

Gjatë kësaj periudhe kjo Njësi statistike ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me drejtoritë rajonale të qarkut, ku nëpërmjet shkresave zyrtare ka kërkuar informacionet në lidhje me të dhënat që disponon secila prej këtyre drejtorive dhe bashkive të qarkut. Ndër to përmendim;

- 1- Bashkitë (të pesta bashkive)
- 2- ZVA Berat, Kuçovë, Skrapar – Poliçan, Urë Vajgurore
- 3- Drejtorisë Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Berat.
- 4- Drejtorisë Rajonale të Tatimeve.
- 5- Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat.

Pozita gjeografike

Rajoni i Qarkut të Beratit shtrihet në pjesën jugore të Shqipërisë së Mesme dhe përbëhet nga rrethet Kuçovë, Berat dhe Skrapar.

Pozita gjeografike e tij është :

- ☐ Gjerësi gjeografike veriore 400 52' 50'' dhe jugore 400 21' 05''.
- ☐ Gjatësi gjeografike lindore 190 33' 43'' dhe perëndimore 200 26' 34''.

Sipërfaqja e qarkut është 1789 km² dhe kufizohet me Qarkun e Korçës, Elbasanit, Fierit dhe Gjirokastrës. Qendrat administrative të rretheve janë Kuçova , Berati (qendër e qarkut) dhe Çorovoda.

Qarku i Beratit, në gjithë gjatësinë e tij, përshkohet nga lumi Osum, ndërsa në veriperëndim përshkohet nga lumi Devoll, i cili bashkohet me lumin Osum në fshatin Arrëz, afro tre kilometra në juglindje të Urës së Kuçit, urë e cila përbën kufirin me rrethin e Lushnjes.

Rrethi i Skraparit përshkohet nga lumi i Guhakut, i cili bashkohet me lumin Osum në qytetin e Çorovodës dhe nga lumi i Tomoricës i cili bashkohet me lumin Devoll në zonën e Gramshit.

përfshirja në rajonin e qarkut e zonës fushore, kodrinore dhe malore e bën këtë rajon, mjaft të pasur me burime natyrore në fushën e turizmit. Zona fushore dhe kodrinore nis me rrethin e Kuçovës, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 80 m, vazhdon me rrethin e Beratit me një terren të pjerrët kodrinor-malor, me

lartësi mesatare 455 m mbi nivelin e detit; duke filluar nga fusha e Beratit dhe deri në lartësinë 1600 m të malit të Shpiragut dhe më tej me rrethin e Skraparit, me lartësi mesatare 750-850 m mbi nivelin e detit që varion nga 250 m në fushën e Bogovës e deri në 1500 m në Faqekuq e Backe, lartësi në të cilën janë vendosur të gjitha fshatrat e këtij rrethi.

Maja më e lartë është maja e Tomorit (Çuka Partizane) prej 2417 m mbi nivelin e detit. I gjithë rajoni i qarkut ka një sipërfaqe me pyje rreth 450 km² dhe rreth 300 km² me kullota. Terreni me pyje, livadhe, kullota; lartësitë malore, pasuritë e mëdha ujore, muzeale, historike, kulturore si dhe klima karakteristike e rajonit, plotësojnë kushte mjaft të mira për zhvillimin e turizmit familjar në rajon.

Berati (quajtur ndryshe dhe si qyteti i një mbi një dritareve) është qyteti i nëntë për nga popullsia në Republikën e Shqipërisë. Qyteti është qendra e [Qarkut të Beratit](#). Gjendet në jugun e vendit, 70 km në vijë ajrore në jug të [Tiranës](#), përshkohet nga lumi Osum dhe rrethohet nga kodra dhe male, ku spikat [Tomori](#), i deklaruar [Park Kombëtar](#).

Gjeografia

Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit [Osum](#), para se ky të dalë në fushën e Myzeqesë, më e madhja e Shqipërisë. Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06"); gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

Relievi

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i [Tomorit](#) (Lindje, 2417m) dhe ai i [Shpiragut](#) (Perëndim, 1218m) si edhe lugina e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Lumenjtë

Lumi i [Osumit](#) rrjedh përmes qytetit dhe jashtë tij, afër [Urës Vajgurore](#), bashkohet me lumin e [Devollit](#); të dy së bashku formojnë [Semanin](#) (gjatësia e tij brenda rrethit 32km). Një nga lumenjtë kryesorë të vendit. Ai paraqet interes për bujqësinë, energjetikën, hidro gjeologjinë, ekologjinë dhe urbanistikën. Sipas treguesve hidrologjikë, për nga gjatësia radhitet i 8-ti, për nga baseni ujëmbledhës i 10-ti, për nga prurja mesatare vjetore i 11-ti dhe për nga lartësia mesatare e rrjedhjes i 4-ti. Krijon rrjedhën e tij të plotë pranë Vithkuqit, vend që merret si pika e fillimit të lumit. Në basenin e Osumit veshja bimore (698 km katror) përbëhet nga pisha, bredhi, dushku e shkurre të tjera mesdhetare. Në zonën e Çorovodës e Skraparit krijon kanione vertikale shumë të bukur, me forma të ndryshme, me thellësi deri 150m e 15-20m të gjera. Osumi transporton në Seman 995 milionë metra kub ujë në vit, me prurje mesatare 32,5m kub sek (në Berat 25-26,9m kub sek). Sasia vjetore e prurjes së ngurtë 1,356 milionë m kub. Gjatësia e Osumit brenda rrethit është 51km.

Klima

Klima e rrethit është tipike mesdhetare, me temperaturë mesatare vjetore 15,9 gradë C. Temperatura mesatare e muajve më të ftohtë është 7,2 gradë C dhe ajo e muajve më të nxehtë 28,2 gradë C. Temperatura absolute më e ulët ka qenë -12,2 gradë C dhe ajo maksimale 47,1 gradë C.

Qytet muze

Në vitin 1961 Berati u shpall zyrtarisht qytet muze, me pasuri të konsiderueshme monumentesh dhe me vlera të larmishme për nga gjinitë, të cilat përbëjnë një dëshmi të trashëgimisë kulturore, historike e artistike, të jetës e të punës, të realizuara mjeshtërisht brez pas brezi nga banorët e tij. Nga zonifikimi dhe nga përcaktimi i kategorisë së monumenteve qyteti ndahet në tri zona : zona muze, zona e mbrojtur dhe zona e lirë.

Sot Berati trashëgon 210 objekte muzeale, nga të cilat 150 janë objekte në këmbë. Prej tyre 60 janë monumente të kategorisë së parë dhe të tjerat të kategorisë së dytë.

Midis këtyre vlerave, nga më të spikaturat janë.


Kështjella



Kalaja e Beratit.

Kështjella ose kalaja, siç quhet nga beratasit është ndërtuar mbi kodrën shkëmbore në formë trekëndëshi, me perimetër të mureve 1440m, me 24 kulla e me dy porta. Me themelet e saj ilire, e rindërtuar disa herë në shekujt VI, XIII, XV dhe XIX ajo është sot jo vetëm një nga kështjellat më të mëdha të banuara, por edhe një arkiv i gurtë që ofron varietete stileshe dhe kontributesh të epokave të ndryshme: ilire, romako -bizantine, shqiptare e turke. Kështjella është pjesë e legjendës së vjetër e të bukur të Tomorit dhe Shpiragut.

Ura e Goricës



Ura e Goricës

Ura e Goricës është një nga monumentet e kulturës dhe të arkitekturës së Beratit dhe njëkohësisht një nga simbolet e tij. Rreth viteve 1780 me përkujdesjen e Ahmet Kurt Pashës, nga urë druri në pjesën e sipërme, ajo u ndërtua e gjitha prej guri. Ajo u rindërtua përsëri duke marrë pamjen që ruan sot, me parmakë betoni, në vitin 1922 nga Bashkia e qytetit. Është 129,3m e gjatë, 5,3m e gjerë, ngrihet 10m mbi lumë dhe ka 7 harqe me hapësira 9 deri 16,7m.

Turizmi



Berati me malin Tomor në horizont

Pas tronditjes që pësoi reputacioni i qytetit në vitin 1997, ka një rivendosje të imazhit të mirë, sidomos këto dy-tre vitet e fundit, kur janë shtuar ndjeshëm flukset e vizitorëve nga vendi, nga Kosova e të huaj. Vërehet një riaktivizim i traditave më të mira të qytetit kundrejt vizitorëve. Tradicionalisht në Berat vizitori ka gjetur mikpritje të veçantë, përjetimin e një ambienti të këndshëm e shplodhës, rastin që të shijojë një kuzhinë karakteristike tradicionale të kombinuar me atë moderne, ku përfshihen ullinj të famshëm, mishi i qengjit dhe ai i gjelit të detit dhe verërat e prodhuara nga vreshtat rreth qytetit.

Degë më e zhvilluar e turizmit deri më tani ka qenë punime të artizanatit. Artizanati, për qytetin është një vlerë e trashëguar e cila mirëmbahet edhe sot në Berat në disa gjini, si: gdhendje në dru qëndistari, punime në argjend dhe në metale të tjera, punime në kashte, gdhendje në pllaka guri, punime dekorative me gur.

Vitet e fundit ka një rigjallërim të këtyre mjeshtërive. Vizitori mund të gjejë në disa dyqane gdhendje me pamje karakteristike të Beratit. Punimet e disa prej mjeshtreve të Beratit janë shpërndarë edhe jashtë vendit.^[5] Në vitin 1901, Berati ishte qendër sanxhaku e varur nga vilajeti i Janinës.^[6]

Turizmi është një ndër drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik të Beratit. Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike e të besimeve, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familjar dhe ai i organizuar. Në disa zona të rrethit (Tomor) mund të zhvillohet turizmi malor me shumë aspekte brenda tij, si edhe gjuetia.



Pamje e Beratit e marrë nga Kalaja

Tashmë vërehet se komuniteti është ndërgjegjësuar në shkallë të ndjeshme për këto vlera, por akoma nuk janë gjetur rrugët adekuate për futjen e shpejtë në efikasitet të këtyre burimeve. Ka shumë për të bërë në drejtim të restaurimit e ruajtjes së vlerave të trashëguara, në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme urbane dhe në promovimin turistik të zonës.

Në Sesionin e 32-të të Komitetit të Trashëgimisë të UNESCO-s të zhvilluar në Kanada më 8 korrik 2008, Berati u regjistrua si sajti i trashëgimisë botërore, nën kriteret III dhe IV.

Kulinaria beratase

Krahas bukurisë së qytetit është kulinaria, shija e mirë, ajo që i lezeton të gjitha. Në fakt Beratit nuk i mungon kuzhina e mirë. Një recetë e shijshme është “[Pula me Rosnica](#)”, që bëhet me thërrime brumi e me pulë fshati; kemi përsheshin me mish gjeldeti në muajt nëntor dhjetor dhe me mish qengji a keci në muajt e tjerë”. E veçanta nuk qëndron te receta e përsheshit, pasi gjithë jugu e gatuan këtë specialitet, por mënyra sesi e gatuajnë beratasis e bën unike këtë recetë. Përpara se ta njomin me lëngun e mishit, ata e skuqin kulaçin e thërrmuar në gjalpë dhe më pas shtojnë lëngun e mishit dhe erëzat që kërkon receta, dhe në fund pjata ka një shije të papërsëritshme. “Ndërsa [sheshqeku](#) është një recetë shumë e vjetër”, “por që në Berat gatuhet vetëm në muajin dhjetor, për shkak të kalorive që ka”. Pjata gatuhet me grurë dhe mish dashi. Mishit i dashit zjehet mirë dhe i hiqen kockat. Ndërkohë zjehet gruri dhe më pas bashkohen të dy përbërësit dhe lihen në zjarr derisa nga yndyra, gruri dhe mishi krijojnë një lloj pelteje.

“Një recetë tepër specifike e cila është tepër e shijshme”. Por Berati ka edhe disa receta të tjera specifike. Si për shembull “[Anabokshana](#)”, një recetë e përgatitur me mëlçi, oriz dhe erëza. Apo ëmbëlsira unike e që bëhet vetëm në Berat, “Mali i bardhë”, apo siç e pagëzuan turistët, “Mont Blanc”. Të gjitha këto receta mund t’i shijoni vetëm në Berat. Askund tjetër. Mjafton të kërkonit pjatat karakteristike dhe ju sigurojmë se shija e tyre do të jetë unike.

Demografia

Qarku i Beratit përbëhet nga 5 bashki, 25 njësi Administrative, 246 fshatra dhe një dendësi prej 128.4 banorë/km².

Qarku i Beratit ka një sipërfaqe prej 18.000 km² dhe një popullsi prej 232.870 banorë.

Mosha mesatare 35.2 vjeç.


Të dhënat e pasqyruara në tabelën e mëposhtme janë marrë nga ministria e brendshme dhe janë për periudhën deri më datën 29.10.2018.

Ndërkohë që të dhënat për popullsinë për vitin 2019 publikohen në faqen zyrtare të Instat-it në vitin 2020.


Nëse do të bënim një krahasim të numrit të popullsisë vëmë re se numri i popullsisë për vitin 2018 dhe 2019 ka një rritje të ulët.

Për sa i përket raportit lindje - vdekje numri i lindjeve ka pësuar një rënie të ndjeshme, ndërsa numri i vdekjeve ka pësuar ndryshime ndër vite.


Popullsia sipas qarkut



Lindjet sipas qarkut, tregues tremujorë



Vdekjet sipas qarkut, tregues tremujorë



Divorcet

Numri i divorceve ka pësuar rritje gjatë viteve të fundit. Qarku i Beratit vetëm gjatë vitit 2018 ka shënuar 409 kërkesa për divorc. Ndër shkaqet kryesore për këtë situatë renditen ato ekonomike, xhelozia, dhuna, martesat me mblesëri

Divorcet kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit në rang vendi. Vetëm në qarkun e Beratit për vitin 2018 ka pasur 409 kërkesa për divorc, ku 329 çifte janë ndarë, ndërsa vetëm 80 raste janë rikthyer në bashkëjetesë. Shkaqet e divorceve janë nga më të ndryshmet por më i përhapuri është gjendja ekonomike.

Prej gati tre vitesh çështjet e zgjidhjes së martesave zënë peshën kryesore të çështjeve civile që gjykohen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Berat. Emigracioni i bashkëshortëve jashtë vendit për të siguruar të ardhura për familjen, puna sezonale në qytete të tjera të vendit, mungesa e besnikërisë, kushtet e vështira ekonomike, diferencat kulturore dhe arsimore kanë qënë shkaqet kryesore të divorceve në qarkun e Beratit. Burimet zyrtare të Gjykatës së Rrethit të Beratit bëjnë me dije se, për vitin 2018 mbërritën pranë kësaj gjykate 409 kërkesa të reja për divorc, ndërkohë që 65 të tjera ishin të mbartura nga viti i kaluar. Për vitin 2018, Gjykata e Beratit zgjidhi martesat për 329 çifte. Shifrat konfirmojnë se, 65% e kërkesave për divorc vijnë nga gratë dhe 35% nga burrat. Avokati Astrit Skëndo, që ndjek prej vitesh çështjet e divorceve, shprehet se shkaqet që po çojnë në rritjen e numrit të kërkesave për zgjidhje martese janë nga më të ndryshmet. Dominojnë shkaqet ekonomike, xhelozia, dhuna, martesat me mblesëri.


Në bazë të statistikave vjetore, rastet e divorceve mësohet se kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Kështu, në vitin 2017, kanë përfunduar me "zgjidhje martese" 153 çifte. Rritja e kërkesave të çifteve për divorc është vënë re që në fillim të vitit 2018, ku vetëm në 3-mujorin e parë të vitit u regjistruan pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat plotë 113 kërkesa për divorc.

Martesar

Edhe pse shqiptarët po zgjedhin çdo vit e më tepër të mos martohen, të paktën në rang kombëtar, në disa rrethe dhe qarqe celebrimet vazhdojnë të jenë në një numër të konsiderueshëm. Qarku i Beratit rezulton qarku i dytë për sa i përket numrit më të lartë të martesave, me rreth 8.6 martesa për 1000 banor.

Ritmi i popullsis sipas Qarkut;

Nga paraqitja e mëposhtme dallohet një rënie e numrit të popullsisë nga viti 2017-2019 e cila lidhet dhe me rënien e numrit të lindjeve.



Popullsia në Qarkun e Beratit në vitin 2018

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	POPULLSIA
1	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Berat R1	21.767
2	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Berat R2	21.410
3	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Berat R3	20.277
4	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Otlak	15.352
5	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Roshnik	3.723
6	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Sinje	5.274
7	Berat	Bashkia Berat	Njësia Administrative Velabisht	12.080
		Bashkia Berat		99.883
8	Berat	Bashkia Kuçovë	Njësia Administrative Kozare	8.351
9	Berat	Bashkia Kuçovë	Njësia Administrative Kuçovë	29.554
10	Berat	Bashkia Kuçovë	Njësia Administrative Lumas	6.960
11	Berat	Bashkia Kuçovë	Njësia Administrative Perondi	10.903
		Bashkia Kucove		55.768
12	Berat	Bashkia Poliçan	Njësia Administrative Poliçan	7.837
13	Berat	Bashkia Poliçan	Njësia Administrative Tërpan	2.323
14	Berat	Bashkia Poliçan	Njësia Administrative Vërtop	7.028

	Bashkia Poliçan			17.188
15	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Bogovë, Njësia Administrative Vëndreshë	2.863
16	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Çepan	940
17	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Çorovodë	5.795
18	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Gjerbes, Njësia Administrative Zhepë	2.076
19	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Potom	1.079
20	Berat	Bashkia Skrapar	Njësia Administrative Qendër SKRAPAR, Njësia Administrative Leshnjë	4.641
	Bashkia Skrapar			17.394
21	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Njësia Administrative Cukalat	4.235
22	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Njësia Administrative Kutalli	13.640
23	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Njësia Administrative Poshnje	10.360
24	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Njësia Administrative Ura Vajgurore	11.814
	Bashkia Ura Vajgurore			40.049
	QARKU BERAT			230.282

Potenciali turistik i rajonit

- Qarku i Beratit është një rajon me potencial të lartë turistik dhe mundësi të mëdha për të zhvilluar lloje të ndryshme të turizmit siç janë:
- **Turizmi kulturor**
- ✓ - Qyteti i Beratit është promovuar si një qendër ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore dhe bazuar në këto vlera të larta, është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO.
- ✓ Pjesa historike e kulturore e qytetit përfshin **lagjet tradicionale të Mangalemit, të Goricës dhe Kalasë, Muzeun Kombëtar të Ikonave, "Onufri" dhe galeritë, muzeumet, kishat dhe xhamitë e të tjera objekte të shumta.**

Turizmi i aventurës –

- Monumentet natyrore të rajonit shtrihen jashtë qytetit, ku veçojmë Parkun Kombëtar të Malit Tomor në të dy anët, zonën e Bogovës, Kanionet e lumit Osum etj, të gjitha këto me një vlerë të mahnitshme të natyrës.
- Vizitat dhe kampingjet turistike apo të peligrinazhit në Malin Tomor, aktiviteti i rafting-ut, që organizohet në kanionet e lumit Osum, kanë filluar të mbështeten edhe nga shoqata të ndryshme turistike e sportive.

- Aktivitetet e shoqatës së parë e për sportin rafting në Shqipëri, kanë ardhur vazhdimisht duke rritur numrin e vizitoreve në këtë rajon.

Turizmi i shijes së prodhimeve dhe kuzhinës tradicionale të rajonit-

- Turnetë e ndryshme që mund të organizohen në rajon do ti prezantojnë vizitorët me mënyrën e prodhimit të artikujve tradicionale dhe të kuzhinës se mrekullueshme të rajonit dhe më pas, ti ftojnë ta shijojnë atë.
- Potenciale të tilla rajoni ka pa fund, ku mund të veçojmë shijimin e prodhimit e vajit të ullirit apo prodhime të tjera karakteristike dhe kuzhinën tradicionale në rajon.



Infrastruktura

Turizmi ndikohet nga infrastruktura rrugore dhe transporti. Aktualisht në Bashkinë Berat ndodhen:

Rrugë inter -urbane kryesore	8.5 km
Rrugë inter-urbane dytësore	12.4 km
Rrugë urbane kryesore	13.2 km
Rrugë urbane dytësore	239.8 km
Rrugë lokale	834 km

Aktualisht nevojitet të riparohen disa prej rrugëve rurale si rruga Berat- Drobonik, Berat-Malinat dhe Berat-Qafë Dardhë. Këto rrugë janë parashikuar për t'u riparuar në kuadrin e partneriteteve strategjike të Bashkisë dhe Qeverisë Shqiptare me Bankën Botërore, BERZH dhe Komisionin Evropian. Në Bashkinë Berat transporti publik mbulon 84 km dhe janë ekzistuese 1 linjë kryesore Uznovë-Kombinat dhe Kombinat-Uznovë si dhe 4 linja kryesore rreth qytetase të cilat lidhin Njësitë administrative Lumas, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë.

Potenciali Turistik në Bashkinë Berat

Bashkia Berat ka potencial të konsiderueshëm të turizmit kulturor dhe turizmit natyror. Turizmi gjithmonë e në zhvillim bazohet mbi këto dy burime të turizmit. Qendra Historike e Qytetit të Beratit është e nënshkruar në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s bazuar në vlerat e arkitekturës së banesave, fortifikimeve të cilat datojnë nga shekulli i IV para Krishtit dhe objekteve fetare me vlera kulturore të cilat datojnë që nga periudha e Mesjetës. Më poshtë janë tabelat me numrin e monumenteve të ndara sipas kategorive përkatëse.

Lagjja Kala

Nr. i Banesave Kategoria I	6
Nr. i Banesave Kategoria II	121
Nr. i Objekteve Fetare Kategoria I	15
Nr. i Objekteve Fetare Kategoria II	1
Monumente të tjera Kategoria I	1
Monumente të tjera Kategoria II	8
Numri Total i Monumenteve	152

Lagjja Mangalem

Nr. i Banesave Kategoria I	9
Nr. i Banesave Kategoria II	105
Nr. i Objekteve Fetare Kategoria I	2
Nr. i Objekteve Pa kategori	4
Monumente të tjera Kategoria I	3
Monumente të tjera Kategoria II	7
Numri Total i Monumenteve	130

Lagjja Goricë

Nr. i Banesave Kategoria I	12
Nr. i Banesave Kategoria II	116
Nr. i Objekteve Fetare Kategoria I	2
Nr. i Objekteve Pa kategori	1
Monumente të tjera Kategoria I	2
Monumente të tjera Kategoria II	3
Numri Total i Monumenteve	136

Zona e Mbrojtur dhe Urbane

Nr. i Banesave Kategoria I	24
Nr. i Objekteve Fetare Kategoria I	1
Monumente të tjera	3
Numri Total i Monumenteve	28

Njësitë Administrative

Monumente Kategoria I	8
-----------------------	---

Pasuri Natyrore në Bashkinë Berat

Pasuri natyrore

Lisi i Çezmës së Prokopisë – Paftal

Rrapi Veleshnjes

Ulliri Drobonikut në Palikësht

Rrapi Burimit – Paftal

Lisat e Çobenjve – Velçan

Lisi i Mbolanit

Lisi i Mbreshtanit

Rrapi në Lagjen Jani Vruho

Rrapi i Zhitomit

Në vitin 2019 kalaja e Beratit është vizituar nga 139 558 vizitorë nga të cilët 71 118 ishin të huaj.

Në Muzeun Ikonografikë "Onufri" dhe Muzeun Etnografikë pati 53 596 vizitorë, prej të cilëve 44 193 ishin vizitorë të huaj.

Në zonat e mbrojtura pati 172 596 vizitorë.

Tabela e vizitorëve që kanë vizituar kalanë e Beratit në vitin 2019

Nr.	MUAJI	Vizitorë vendas	Çmimi	Vizitorë huaj	Çmimi	Totali/ lekë	Vizitorë me biletë	Vizitorë pa biletë	Totali Vizitorëve
1	Janar	2,592	100	765	100	335,700	3,357	50	3,407
		31	50			1,550	31		31
		58	30			1,740	58	782	840
2	Shkurt	1,460	100	598	100	205,800	2,058	25	2,083
		15	50			750	15	310	325
		261	30			7,830	261		261
3	Mars	2,092	100	1,320	100	341,200	3,412	1,618	5,030
		26	50			1,300	26		26
		455	30			13,650	455	424	879
3 MUJOR I		6,990		2,683		909,520	9,673	3,209	12,882
4	Prill	1,504	100	3,782	100	528,600	5,286	210	5,496
		24	50			1,200	24		24

		2,194	30			65,820	2,194	576	2,770
5	Maj	2,778	100	8,881	100	1,165,900	11,659	3,167	14,826
		44	50			2,200	44		44
		6,475	30			194,250	6,475	1,176	7,651
6	Qershor	1,563	100	8,333	100	989,600	9,896	1,146	11,042
		28	50			1,400	28		28
		1,747	30			52,410	1,747	831	2,578
3 MUJOR II		16,357		20,996		3,001,380	37,353	7,106	44,459
7	Korrik	2,345	100	9,022	100	1,136,700	11,367	376	11,743
		155	50			7,750	155		155
		160	30			4,800	160	1,249	1,409
8	Gusht	7,522	100	14,625	100	2,214,700	22,147	405	22,552
		343	50			17,150	343		343
		149	30			4,470	149	2,642	2,791
9	Shtator	4,916	100	13,246	100	1,816,200	18,162	669	18,831
		32	50			1,600	32	664	696
		228	30			6,840	228		228
I 3 MUJOR III		15,850		36,893		5,210,210	52,743	6,005	58,748
10	Tetor	2,978	100	8,901	100	1,187,900	11,879	715	12,594
		28	50			1,400	28		28
		1,870	30			56,100	1,870	576	2,446
11	Nëntor		100		100	0	0		0
			50			0	0		0
			30			0	0		0
12	Dhjetor		100		100	0	0		0
			50			0	0		0
			30			0	0		0
3 MUJOR IV		4,876		8,901		1,245,400	13,777	1,291	15,068
TOTALI 2019		44,073	0	69,473	0	10,366,510	113,546	17,611	131,157

*Muaji Tetor i vitit 2019 ka 2109 vizitorë më shumë se Tetori i vitit 2018.

*Periudha Janar - Tetor 2019 ka 7717 vizitorë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2018.

*Gjatë muajit Tetor e kanë vizituar Kalanë rreth 20 grupe me afërsisht 20 vetë secili. Zakonisht grupet shoqërohen me 2 guida, një shqiptar dhe një të huaj. Guidat janë gjithmonë jashtë sitit, dhe përbërja e grupeve janë kryesisht turistë të huaj.

*Nacionaliteti i turistëve të huaj është kryesisht: Gjermanë, Italianë, Bullgarë, Francezë, Sllovenë, Amerikanë, Spanjollë etj.

Bashkia Skrapar

Bashkia Skrapar është një nga bashkitë, me potencial të mëdha, reale, ende të pashfrytëzuara plotësisht, për zhvillimin e turizmit lokal. Këto potenciale, lidhen me turizmin natyror, turizmin e trashëgimisë historike, turizmin e trashëgimisë së periudhës komuniste, turizmin e kulinarisë dhe produkteve bio, turizmin kulturor etj.

Asetet natyrore që Bashkia Skrapar aktualisht ka, si Kanionet e Osumit, Parku Kombëtar i Malit të Tomorit, Ujëvara e Bogovës, Shpella e Pirogoshit, Ura e Kasabashit, Fusha e Lirëzës etj, janë asete tashmë të evidentuara jo vetëm nga qeverisja lokale por dhe ajo qendrore.

Kanionet e Osumit dhe Parku Kombëtar i Malit të Tomorit janë përfshirë në Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e turizmit, duke u shpallur si zona prioritare për investime në këtë fushë.

Në territorin e Bashkisë Skrapar janë shumë vendbanime të hershme, qytetërime të llojit kështjella, të cilat janë shpërndarë në territorin e bashkisë, por që ende nuk janë përfshirë, në guidat turistike për t'ua bërë të njohur turistëve.

Kalaja e Zelenckës, Prishtës, Qeshibesit, Gradecit, Gorës Potom, Hamamet e Slatinjës etj, janë potenciale me mjaft interes për zhvillimin e turizmit, dhe rrjetëzimi i tyre nëpërmjet projekteve, në të ardhmen, do t'i kthente ato në potenciale reale për zhvillimin e turizmit lokal. Skrapari i konsideruar nga regjimi komunist si kryeqyteti i vendit, në rast lufte, ruan një nga fortifikimet më moderne e më interesante të asaj periudhe, tunelet e Krorëzës, të ndërtuara për strehimin e udhëheqjes komuniste në rast lufte.

Krahas këtij vendstrehimi, në zonë ndodhen tunelet për ruajtjen e thesarit të shtetit në Çorovodë, si dhe një rrjet tunelesh, të ndërtuara pranë kanioneve të Gradecit, të cilat kanë një vlerë shumë të madhe, për zhvillimin e turizmit lokal, por që kanë nevojë për një promovim dhe aksesim më të madh.

Infrastruktura turistike dhe ndikimi i saj në zhvillimin e turizmit

Bashkia Skrapar, ka arritur që nëpërmjet projekteve të ndryshme të ndërtojë infrastrukturën turistike, të munguar totalisht më parë. Ëëbsit-t visit Skrapar është një ëëbsite mjaft profesional, i cili u mundëson turistëve, që të marrin gjithë informacionin e kërkuar, për të vizituar zonën.

Bashkia ka një zyrë turizmi dhe një info point në qendër të qytetit, ku turistët mund të drejtohen dhe të marrin informacion, mbi atë çka dëshirojnë të vizitojnë në zonë.

Përgjatë kanioneve të Osumit, për të aksesuar zhvillimin e aktiviteteve lumore të raftingut dhe kayakut, bashkia ka ndërtuar pikën hyrëse dhe atë dalëse ku turistët mund të marrin shërbimet e nevojshme për këto aktivitete. Janë ndërtuar dy pika panoramike, në vendet më të bukura të kanioneve, ku turistët mund të shijojnë bukurinë e kanioneve. Për të aksesuar, një nga destinacionet më të vizituara, Ujëvarën e Bogovës, është rikonstruktuar shtegu, që të çon në këtë ujëvarë. U rikonstruktura dhe u bë funksional shtegu që të çon në Shpellën e Pirogoshit. Me ndërhyrjen e Ministrisë së Kulturës, u rikonstruktura Ura e Kasabashit.

Bashkia Skrapar vizitohet nga një numër relativisht i lartë turistësh, pothuajse gjatë gjithë vitit, por ky turizëm është kryesisht ditor, e lidhur kjo me numrin e pakët të strukturave akomoduese, si dhe standardet e shërbimit, ende jo në nivelet e kërkuara nga ky sektor.

Kanionet e Osumit dhe Mali i Tomorit, mbetet gjithmonë preferencë e turistëve të huaj të cilët vijnë në mënyrë të organizuar nga shoqatat e operatorëve turistikë por dhe në mënyrë spontane.

Vendet nga vijnë këta turistë janë të ndryshëm si Italia, Franca, Gjermania, Polonia, Çekia, USA, etj. Ky numër shkon mbi 20 mijë turistë që së bashku me turistët vendas numri shkon në rreth 45 mijë. Bashkia Skrapar, e ndërgjegjshme për potencialet e saja në zhvillimin ekonomik të zonës, po punon ngushtësisht me operatorët turistik në zonë, për ti orientuar ata drejt formave të reja të turizmit familjar, agro turizmit me qëllim që zona të arrijë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, nëpërmjet turizmit.

Bashkia Poliçan

Bashkia Poliçan, për shkak të relievit dhe natyrës së pasur, është e përqendruar kryesisht në turizmin malor. Aktualisht më shumë i përhapur është turizmi familjar për shkak edhe të numrit të vogël të hoteleve. Ka një numër të konsiderueshëm të restoranteve që ofrojnë kryesisht ushqim tradicional të zonës krejtësisht bio. Për sa i përket infrastrukturës, ajo është tejet e rëndësishme në zhvillimin e turizmit. Konkretisht infrastuktura në fshatrat që kanë potenciali turizmi është e dëmtuar. Në projektin e 100 fshatrave Bashkia Poliçan është pjesë me fshatin Kapinovë i cili është një fshat rrëzë Tomorit me një potencial të jashtëzakonshëm për turizëm. Njëkohësisht janë edhe një sërë fshatrash të tjerë si Tomori, Lybesha, të cilët për shkak të infrastukturës e kanë të pamundur zhvillimin e turizmit pavarësisht se janë potenciale të jashtëzakonshme.

Bashkia UraVajgurore

Bashkia Ura Vajgurore ka në territorin e saj monumente kulturore të cilat vijojnë si më poshtë:

-Ura e Frëngut ose Ura e Kaurit në fshatin Poshnje, Njësia Administrative Poshnje.

-Shpella e Shahinovës në lagjen Gurore fshati Pashalli, Ura Vajgurore.

-Kisha e Vokopolës në fshatin Vokopolë, Ura Vajgurore.

-Kalaja e Dimalit në fshatin Krotinë, Njësia Administrative Cukalat.

-Pylli i Gajdës, në fshatin Gajdë, Njësia Administrative Poshnje.

-Çezma e Ujit të Ftohtë në fshatin Poshnje, Njësia Administrative Poshnje.

-Kisha e Shën Pjetrit në fshatin Poshnje, Njësia Administrative Poshnje.

-Pikturat Muralet Filtrimi (The flirt), “Kampioni” (The Champion) dhe “ Ura e Mendjes”(Bridge of mind). Këto piktura janë përzgjedhur nga revista prestigjioze zvicerane “Eild Ealls” si një nga 10 më të mirat në botë.

Për sa i përket numrit të turistëve mund të themi që numri i tyre vazhdon të rritet dita ditës. Pikturat murale po vizitohen çdo ditë e më shumë nga turistë vendas e të huaj nga shtetet si, Izraeli, Kina, Amerika, Anglia, Spanja dhe shumë shtete të tjera.

Bashkia Berat

NR	Emri i veprimtarisë	Bashkia Berat	Nr.i dhomave
1	Agrobujtina Alpeta Roshnik	1	8
2	Bujtina	2	7
3	Enkelejda Gojka	1	
4	Guest house:"Hava Baci"	1	2
5	Guesthouse	5	15
6	Hostel	6	23
7	Hotele	37	393
8	Local Living Edi	1	2
9	OliveB&B	1	3
10	Nuriye Isufi	1	
11	Shtëpi pritëse:"Lorenc Pushi"	1	2
12	Vila	4	9
	Total	61	464

Bashkia Skrapar

Nr	Emërtimi i Strukturës akomoduese	Nr dhomave	Dyshe	Teke	Treshe	Totali
1	Hotel Qato Bogovë	12	8	2	2	24
2	Hotel Dafinat Bogovë	6	4	2	-	10
3	Hotel Çela Bogovë	10	6	4	-	16
4	Hotel Osumi Çorovodë	12	10	2	-	22
5	Hotel Shpëtimi Çorovodë	10	8	2	-	18
6	Hotel Kalemi Çorovodë	12	12	-	-	24
7	Hotel Turizmi Çorovodë	18	14	4	-	32
8	Hotel Fatjoni Çorovodë	4	4	-	-	8
9	Hotel Sokoli Çorovodë	4	4	-	-	8
10	Hotel Kanionet Çorovodë	32	26	4	2	62
11	Hotel Flora Çorovodë	8	8	-	-	16
12	Hotel Shefqeti Ujanik	6	6	-	-	12
	Nr. i vendeve komplet	134	110	20	4	252

Bashkia Skrapar, ka një rrjet restorantesh, të shpërndarë në zonat me potencial turistik si Bogovë, Çorovodë, Gjerbës, Potom, Vëndreshë, etj. Në restorante gatuhet kuzhina tradicionale e zonës e shoqëruar me pijen tipike rakinë e Skraparit dhe pijet tjera, vera e kuqe dhe e bardhë sipas shijes dhe gustos së turistëve. Në territorin e Bashkisë Skrapar janë dhe dy kantina për prodhim rakinë dhe vere, kantina Naço dhe Albalejla.

Nr	Emërtimi i restorantit	Vendndodhja
1	Restorant Kujtim Bakiu	Bogovë
2	Restorant Çela	Bogovë
3	Restorant Dafina	Bogovë
4	Restorant Qato	Bogovë
5	Restorant Shamo	Bogovë
6	Restorant Osumi	Çorovodë
7	Restorant Kanione	Çorovodë
8	Restorant Ylli Streneci	Çorovodë
9	Restorant Kalemi	Çorovodë
10	Restorant Verori	Çorovodë
11	Restorant Bedri Ymeri	Çorovodë
12	Restorant Ladi Xhizdari	Çorovodë
13	Restorant Xhamajka	Çorovodë
14	Restorant Qetësia	Çorovodë
15	Restorant Kamping	Çorovodë

Bashkia Poliçan

Nr	Emërtimi i restorantit	Vendndodhja
1	Fatmire Demiri	Hoxhaj
2	Ferdi Murataj	Fushë-Peshtan
3	Adriatik Salillari	Fushë-Peshtan
4	Mario Koromani	Poliçan

Në Bashkinë Poliçan ndodhet vetëm një hotel me kapacitet 10-12 persona.

Bashkia Kuçovë

Nr	Emri	Adresa	Gr.Përgj.Biznesi Përshkrimi	Statusi	Përshkrim Grup Postimi
B-0069	Liliana Shkëmbi	Kuçovë	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0070	Fatos Pulake	Kuçovë	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0071	Xhevaire Tusha	Kuçovë	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0072	Armando Malasi	Kuçovë	BV-TREGTI	Ç'regjistruar	Restorant
B-0073	Suzana Musai	Kuçovë	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0074	Spiro Bizdani	Kuçovë	BV-TREGTI	Ç'regjistruar	Restorant
B-0374	Fatos Sulovari	Kozare	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0375	Ramadan Grëmshi	Kozare	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0570	Leonora Oboni	Perondi	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0571	Pëllumb Berzeshta	Perondi	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0572	Osmen Pirja	Perondi	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0619	Dituri Sado	Lumas	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0641	Emanuel Saraseli	Lumas	BV-TREGTI	Ç'regjistruar	Restorant
B-0642	Artur Zaimi	Lumas	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0740	Apostol Jakupi	Tafil Skendo	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant
B-0888	Idaet Plaku	Tapi	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-0937	Arenci Runga	T.Skendo	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-1008	Ardit Bizdani	T.Skendo	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-1033	Mohamed A.I Soboh	11 Shkurti	BV-TREGTI	Pezulluar	Restorant
B-1037	Bujar Suli	Tapi	BV-TREGTI	Aktiv	Bar-Restorant
B-1076	Shqiponja Sulovari	Havaleas	BV-TREGTI	Aktiv	Restorant

Lista e restoranteve në Bashkinë Berat

Nr.	Subjekti	NUIS	Adresa	Emër subjekti
1	Dhimitër Leka	K73208018C	Lagjja ‘30 Vjetori’	Taç Leka
2	Besmir Kalluci	L03016005A	Lagjja “22 Tetori”	Çuçi
3	Gabriela Kadena	L13001003B	Lagjja ‘Mangalem’	Guva
4	Juliana Çobo	L22517004L	Lagjja ‘Mangalem’	Shtëpia e Bardhë
5	Lumturi Likaj	L43301006O	Lagjja “22 Tetori”	
6	Altin Molishti	L52804002L	Lagjja “22 Tetori”	Shtëpia e birrës
7	Elona Dyli	L52604002F	Lagjja “13 Shtatori”	Shtëpi Birre
8	Xhentila Memaj	L53205002A	Lagjja “Muzakaj”	
9	Migena Dyshniku	L62906003K	Lagjja” 30 Vjetori”	
10	Eno Shemilli	L73210001T	Lagjja “30 Vjetori”	
11	Ëildor	L82510003U	Lagjja “Mangalem”	Ëildor
12	Besmir Shehu	L82504001U	Lagjja “28 Nëntori”	
13	Sulltane Hoxha	L83522001U	Lagjja “Muzakaj”	Fast-Food Andi
14	Qerim Nallbani	L13315001S	Lagjja “Uznovë”	Osumi
15	Nertila Myftari	L32601003T	Lagjja “Uznovë”	Taverna Ago
16	Valbona Straficka	L33505001A	Lagjja “Jani Vruho”	Straficka
17	Engjell Tabaku	L13306001T	Lagjja “Kala”	Koçi
18	Leonidha Semi	L43004001D	Lagjja “Kala”	Klea
